



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

DETYRIMET NDËRKOMBËTARE TË KOSOVËS PËR TË VEPRUAR ME NJË POLITIKË MODERNE TË KONKURENCËS

SIGURIMI I PËRFITIMEVE NGA
KONKURRENCA E DREJTË

2



**SIGURIMI I PËRFITIMEVE NGA
KONKURRENCA E DREJTË
(Broshura Nr.2)**

DETYRIMET NDËRKOMBËTARE TË KOSOVËS PËR TË VEPRUAR ME NJË POLITIKË MODERNE TË KONKURRENCËS

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar) ¹, **Autoriteti i Kosovar i Konkurrencës** (AKK) është institucioni kryesor në Kosovë përgjegjës për parandalimin dhe ndalimin e praktikave anti-konkurruese (përfshirë marrëveshjet e ndaluara, abuzimet me pozitat dominuese të tregut, mbikëqyrjen e blerjeve/bashkimeve) dhe aspektet e avokimit në fushën e konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës i Kosovës përbëhet nga **Komisioni Kosovar i Konkurrencës** (KKK) si një organ kolegjal vendimmarrës dhe Sekretariati i përbërë nga nëpunës civilë profesionistë, hetues dhe staf ndihmës. Sipas ligjit, Komisioni i Konkurrencës është pjesë e Autoritetit dhe menaxhon punën e tij. Përbëhet nga pesë anëtarë. Këta anëtarë duhet të jenë të lirë nga konfliktet e interesit me sektorin e biznesit dhe Komisioni raporton te dhe mbikëqyret nga Kuvendi i Kosovës.

Derisa puna e Autoritetit është shumë e përqendruar në aktivitetet e biznesit në tregun e Kosovës, legjislacioni i tij qeverisës dhe qasjet operacionale në mënyrë progresive bazohen në standardet dhe legjislacionin ndërkombëtar (veçanërisht të BE-së). Për më tepër, kjo qasje është e frymëzuar nga disa marrëveshje ndërkombëtare në të cilat Kosova është palë dhe të cilat, në interes të tregtisë së lirë dhe të ndershme dhe marrëdhënieve më të ngushta BE-Kosovë, kërkojnë standarde të larta të konkurrencës së ndershme në Kosovë.

Këto marrëveshje dhe kërkesat e tyre në lidhje me ligjin dhe politikën e konkurrencës në Kosovë shpjegohen këtu.

¹ Ligji (Nr. 03 / L -229) për Mbrojtjen e Konkurrencës (2010) i ndryshuar me Ligjin (Nr. 04 / L-226) për *Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit* Nr. 03 / L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (2014)

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE-Kosovë (MSA)²

Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit të BE-së përbëjnë kornizën e marrëdhënieve midis Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor për zbatimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit. Marrëveshjet janë përshtatur me situatën specifike të secilit vend partner dhe, ndërsa krijojnë një zonë të tregtisë së lirë midis BE-së dhe vendit në fjalë, ato gjithashtu identifikojnë objektivat dhe reformat e përbashkëta politike dhe ekonomike dhe inkurajojnë bashkëpunimin rajonal. Në kontekstin e anëtarësimit të mundshëm në Bashkimin Evropian, Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit shërbejnë si bazë për zbatimin e procesit të anëtarësimit³.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE-Kosovë hyri në fuqi në Prill 2016.

Në lidhje me konkurrencën, detyrimi kryesor për Kosovën është të për afrojë, ose bashkërendis, ligjet e saja dhe sistemet e zbatimit me ato të BE-së⁴ në mënyrë që të sigurojnë që:

- a) të gjitha marrëveshjet midis ndërmarrjeve, vendimet nga shoqatat e biznesit dhe praktikant e bashkërenduara ndërmjet kompanive të cilat kanë si objekt ose efekt parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës janë të rregulluara dhe të eliminuara;
- b) abuzimet nga një ose më shumë kompani me një pozicion dominues në tregun e Kosovës, ose një pjesë e konsiderueshme e tij, janë të rregulluara dhe të eliminuara;

² Këshilli i Bashkimit Evropian - *Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, nga njëra anë dhe Kosovës nga pjesa tjetër*, 2 tetor 2015. Marrëveshja është në fuqi që nga Prilli 2016. Teksti i plotë i marrëveshja është e arritshme në:

https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/stabilisation_and_association_agreement_eng_0.pdf

³ BE ka negociuar dhe përfunduar Marrëveshjet e *Stabilizim Asociimit* me: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Kosovën..

⁴ MSA, neni 74.

- c) çdo Ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë thelbësisht konkurrencën dhe tregtinë është rregulluar dhe eliminuar⁵;
- d) brenda tre viteve pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, pikat (a) deri (d) zbatohen gjithashtu për ndërmarrjet publike dhe për ndërmarrjet të cilave u janë dhënë të drejta të veçanta dhe ekskluzive (p.sh. me kontratat e koncesionit).

Për më tepër, edhe para bashkërendimit të legjislacionit të Kosovës me ligjin e BE-së në këto fusha, çdo praktikë në kundërshtim me pikat e mësipërme duhet të vlerësohet në Kosovë në bazë të kritereve që dalin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të zbatueshme në BE. Kjo lejon, për shembull, masat e zbatimit të konkurrencës të tejkalojnë rregullat e ligjit kombëtar, në raste të përshtatshme, në bazë të supremacisë së traktateve ndërkombëtare të ratifikuara siç parashikohet në nenin 19 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kjo gjithashtu do të thotë që legjislacioni i Kosovës për konkurrencën (dhe Ndihmën shtetërore) duhet të përshtatet me çdo legjislacion të ri të BE - për shembull "Direktiva ECN+ 2019"⁶ e vitit 2019 paraqiti ndryshime të rëndësishme në lidhje me të drejtat dhe detyrat e autoriteteve të konkurrencës në Shtetet Anëtare të BE.

Autoriteti është i përfshirë me pikat (a) dhe (b) më sipër, dhe pjesërisht me pikën (d). Këto pika në thelb kanë të bëjnë me sjelljen e ndërmarrjeve publike dhe private në treg - e cila duhet të jetë e ndershme dhe të mos kërcënojë biznesin e kompanive të tjera duke (aktualisht ose potencialisht) zvogëluar ose eliminuar konkurrencën. Ligji për Ndihmën Shtetërore i vitit 2016 themeloi veçmas Komisionin e Ndihmës Shtetërore dhe Departamentin e Ndihmës Shtetërore të Ministrisë së Financave në lidhje me pikën (c) dhe aspektet e tjera të pikës (d)⁷. Kështu, ndërsa Autoriteti përqendrohet në sjelljen e

⁵ MSA, neni 75.

⁶ Direktiva (BE) 2019/1 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 Dhjetorit 2018 për të fuqizuar autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare për të qenë zbatues më efektivë dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut të brendshëm, OJ L 11 i 14 Janarit 2019.

⁷ *Ndihma shtetërore* ka të bëjë kryesisht me ndikimin në konkurrencën dhe tregtinë e subvencioneve, lehtësimet tatimore dhe format e tjera të ndihmës qeveritare që përfitojnë disa kompania dhe, për këtë arsye, mund të ndikojnë negativisht në kompanitë e tjera..

kompanive në lidhje me konkurrencën, sektori i ndihmës shtetërore trajton veprimet e caktuara anti-konkurruese nga Shteti. Në të dy rastet, objektivi përfundimtar është konkurrenca e lirë dhe e ndershme, e cila në fund të fundit është në përfitim të gjithë konsumatorëve (në formën e çmimeve më të ulëta dhe mallrave dhe shërbimeve me cilësi më të lartë).

Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE)⁸

Traktati i Komunitetit të Energjisë u nënshkrua në Athinë në tetor 2005 dhe hyri në fuqi në korrik 2006. Traktati krijoi Komunitetin e Energjisë si një organizatë ndërkombëtare që merret me politikën e energjisë. Traktati mbledh Bashkimin Evropian, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër vendet e Evropës Juglindore dhe rajonin e Detit të Zi⁹. Kosova është anëtare e TKE që nga 1 korriku 2006.

Qëllimi kryesor i organizatës është të shtrijë tregun e brendshëm të energjisë të BE-së në Evropën Juglindore dhe më gjerë në bazë të një kornize ligjrisht të detyrueshme. Për më tepër, TKE kërkon:

- **Të tërheqin investime** në prodhimin e energjisë dhe rrjetet për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të energjisë që është thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin shoqëror;
- **Krijimi i një tregu të integruar të energjisë**, duke lejuar tregtinë ndërkufitare të energjisë dhe integrimin me tregun e BE-së;
- **Rritja e sigurisë së furnizimit**;
- **Përmirësimi i situatës mjedisore** në lidhje me furnizimin me energji në rajon; dhe

⁸ Traktati për Themelimin e Komunitetit të Energjisë i nënshkruar në tetor 2005 në Athinë, Greqi, në fuqi që nga Korriku 2006. Tekstin e plotë të Traktatit mund ta shihni në: <https://www.energy-community.org/legal/treaty.html>

⁹ Përveç Bashkimit Evropian, palët kontraktuese të TKE-së janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia Veriore, Moldova, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova.

- **Rritja e konkurrencës** në nivelin rajonal dhe shfrytëzimi i ekonomive të shkallës.

Nën pikën e fundit, TKE parashikon që marrëveshjet midis ndërmarrjeve, vendimet nga shoqatat e biznesit dhe praktikat e bashkërenduara midis kompanive që kanë si objekt ose efekt parandalimin thelbësor, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës, abuzimet nga një ose më shumë kompani me një pozitë dominuese në tregu në Kosovë, ose një pjesë e konsiderueshme e saj, ndihma publike e cila shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë ndjeshëm konkurrencën dhe tregtinë dhe efektet anti-konkurrese në lidhje me ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet të cilave u janë dhënë të drejta speciale dhe ekskluzive janë të papajtueshme me Traktatin – dmth ato nuk lejohen¹⁰.

Ndërsa dispozitat e konkurrencës TKE janë shumë të ngjashme me ato të MSA-së, një ndryshim i rëndësishëm është se ato zakonisht nuk lejojnë ndonjë periudhë kalimtare për të zhvilluar legjislacionin ose sistemet në Kosovë, d.m.th. ato zbatohen nga momenti i ratifikimit të Traktatit.

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA)¹¹

Qëllimet kryesore të marrëveshjes CEFTA janë:

- zgjerojë tregtinë e mallrave dhe shërbimeve dhe nxit investimet me anë të rregullave të drejta, të qëndrueshme dhe të parashikueshme,
- të eliminojë pengesat në tregtinë ndërmjet palëve,
- të sigurojë mbrojtjen e duhur të të drejtave të pronësisë intelektuale në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- harmonizojë dispozitat mbi çështjet moderne të politikës tregtare siç janë rregullat e konkurrencës dhe ndihmën shtetërore, dhe
- të sigurojë procedura të qarta dhe efektive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

¹⁰ Traktati i Komunitetit të Energjisë, nenet 18 dhe 19.

¹¹ Versioni i konsoliduar i *Marrëveshja e tregtisë së lirë e Evropës Qendrore (CEFTA 2006)*. Tekstin e plotë të Marrëveshjes mund ta shihni në: <https://cefta.int/legal-documents/#1463498231136-8f9d234f-15f9>

Marrëveshja përputhet plotësisht me rregulloret e BE-së dhe rregullat dhe procedurat e Organizatës Botërore të Tregtisë. Sipas Sekretariatit të CEFTA-s:

“E zbatuar në mënyrë efektive, Marrëveshja siguron një kornizë të shkëlqyeshme për Palët që të përgatiten për pranimin në BE, duke vazhduar kështu traditën e CEFTA-s origjinale, anëtarët themelues të së cilës tani janë në BE¹²”.

Marrëveshja CEFTA e vitit 2006 rezultoi nga përditësimi i marrëveshjes së mëparshme CEFTA 1997 dhe zgjerimi i anëtarësisë së saj¹³. Përveç dispozitave dhe termave të përgjithshëm në lidhje me tregtinë e mallrave bujqësore dhe industriale, CEFTA aktuale përfshin një sërë dispozitash specifike në lidhje me politikën e konkurrencës.

Dispozitat e CEFTA-s në lidhje me konkurrencën kanë një fokus të ngjashëm në marrëveshjet anti-konkurruese, abuzimet me pozitat dominuese të tregut, rregullimin e ndihmës shtetërore dhe zbatimin e rregullave të BE-së në lidhje me ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjeve të cilave u janë dhënë të drejtat speciale dhe ekskluzive. Përsëri, çdo praktikë në kundërshtim me rregullat e konkurrencës CEFTA duhet të vlerësohet në Kosovë në bazë të kriterëve që dalin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të zbatueshme në BE. Për më tepër, që nga viti 2010, asnjë periudhë kalimtare nuk zbatohet për rregullat e konkurrencës CEFTA. Për më tepër, ankesat nga anëtarët e CEFTA-s në lidhje me cilindo vend që lejon shkelje të rregullave të CEFTA-s mbi konkurrencën që shkakton ose kërcënon të shkaktojë paragjykim serioz të interesit të vendit ankues ose dëmtim material të industrisë së tij vendase, mund të ndiqen përmes procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në nenin 24 të Marrëveshjes.

¹² <http://cefta.int/>

¹³ Anëtarësia aktuale e ECFTA-s përbëhet nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia Veriore, Moldova, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova.

Përmirësimi i kornizës për Politikën e Konkurrencës në Kosovë

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), së bashku me legjislacionin sekondar të caktuar¹⁴, i jep autorizime të rëndësishme Autoritetit për të rregulluar marrëveshjet anti-konkurrese, abuzimet e dominimit të tregut, përqendrimet e ndërmarrjeve që mund të shkaktojnë shqetësime të konkurrencës dhe të japin mendime dhe rekomandime për organe të tjerë që synojnë rregullimin e problemeve të konkurrencës. Ky legjislacion, pra, shkon shumë larg në drejtim të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës për të vepruar me një politikë moderne të konkurrencës siç përshkruhet këtu.

Sidoqoftë, Qeveria dhe Autoriteti janë të vendosur të ndërmarrin hapat e përfundimtarë për të siguruar që politika e konkurrencës, në përputhje me standardet ndërkombëtare, të zbatohet plotësisht në Kosovë. Legjislacioni primar i konkurrencës i Kosovës daton që nga viti 2010 dhe nuk është rishikuar dhe ndryshuar që nga viti 2014. Tashmë në vitin 2017, *Strategjia Kombëtare e Zbatimit për MSA-në për vitet 2018-2022* identifikoi disa çështje si Objektivat e Prioritetit Afatmesëm të Kosovës për Konkurrencën. Këto përfshinë përditësimin e mëtejshëm të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (përfshirë përafrimin e plotë të Rregullores për Bashkim të BE¹⁵) dhe forcimin e rolit avokues të Autoritetit të Konkurrencës me palët kryesore të interesit. Këto përmirësime janë planifikuar të përfshihen në vitin 2021.

¹⁴ Shih https://ak.rks-gov.net/en/kuadri_ligjor

¹⁵ Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 139/2004 e 20 janarit 2004 për kontrollin e përqendrimit në mes të ndërmarrjeve (Rregullorja për Bashkim e KE-së), OJ L 24 e 29 janarit 2004.

Informacionet e mëtejshme

Për informacione të mëtejshme, shihni broshurat e tjera në serinë e AKK-së ***“Sigurimi i përfitimeve nga Konkurrenca e Drejtë ”*** dhe vizitoni faqen tonë në internet: <https://ak.rks-gov.net/>



Funded by
the European Union



Kjo broshurë është përgatitur me ndihmën e Projektit të financuar nga BE: "Mbështetje e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore" menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe zbatuar nga një Konsorcium I B&S Europe

